



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ р./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit), në seancën e 94-të të mbajtur më 13.10.2023, ka miratuar sa vijon.

VENDIM

Denoncimi me numër 12-1611/1 nga 07.03.2022, me akuzë për heqje të paligjshme të lirisë, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent sepse KSHPK-ja tashmë ka vepruar dhe ka marrë vendim për një rast me të njëjtat pretendime.

Lënda me numër 12-1611/1 të 07.03.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së duhet në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Më datë 07.03.2022, një kërkues i njohur ka bërë denoncim me pretendime për heqje të paligjshme të lirisë dhe është konstatuar rasti me numër 12-1611/1, datë 03.07.2022.

Në kërkesë thuhet se është dorëzuar në MPB Shkup për shkak të privimit të kundërligjshëm të lirisë. Po ashtu, ndaj disa institucioneve ngrihen akuzë për rrëmbim dhe ndalim të paligjshëm të një fëmije, si dhe për fshehje të veprimeve të tilla nga institucionet kompetente.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja konstaton se tashmë ka vepruar sipas pretendimeve nga denoncimi i cekur në lëndën me nr. 12-7901/1 të 22.08.2022 për të cilën në seancën e 88-të të KSHPK-së të mbajtur më 16.06.2023 ka marrë Vendim për refuzimin e kërkesës për shkak të mungesës së elementeve për veprim kompetent.

Në bazë të sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Dorëzuar: parashtruesi i denoncimit

**KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**

Përgatiti: B.K:SH
Miratoi: G.T., Anëtar i KSHPK-së

**Kryetar,
Biljana Ivanovska**

